

# PRAKTIKA TË MIRA PËR TË NXËNËT NË KLASË NGA MËSUESIT E EKIPIT LËNDOR TË SHKENCAVE SOCIALE, GJUHËS DHE KOMUNIKIMIT

## 1.METODA: ‘TURI I GALERISË’

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa e 7A, me temë mësimore “Vdekja e lisnajës” dhe me koncept kryesor *poster për mbrojtjen e mjedisit*, metoda e parashikuar në planin e orës mësimore “Turi i galerisë” më mundësoi që të gjithë nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Nxënësit u informuan për elementet përbërës të një posteri, duke parë dhe shembuj konkretë.
- Pas diskutimit të realizuar në klasë mbi mënyra të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, ata janë udhëzuar të krijojnë një poster për mbrojtjen e mjedisit, në të cilin duhet të ketë një slogan tërheqës dhe ilustrime që paraqesin idenë e nxënësit.
- Secili nxënës do të prezantojë posterin e tij para klasës, duke dhënë shpjegimet, për ilustrimet e përdorura dhe sloganin përkatës.
- Me shokun e bankës ata do të bëjnë vlerësimet e punimeve të njëri-tjetrit, duke nxitur diskutim dhe mendim kritik për detyrën e bërë.
- Në fund, të orës mësimore, punimet i vendosim në këndin e klasës, duke krijuar kështu një minigaleri me punimet e nxënësve, të cilat vlejné për të na kujtuar se sa punë të bukura mund të realizojmë.
- Gjatë prezantimit të punimeve të nxënësve, u vu re që nxënësit e kishin përvetësuar shumë mirë konceptin e *krijimit të një posteri* dhe shpalosën aftësi të larta kreativiteti dhe të të menduarit kritik.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën “Turi i galerisë” , sepse krijon përfshirje të lartë në të nxënë duke nxitur zhvillimin e aftësive krijuese, prezantuese dhe të menduarit kritik.

Mësuesja Blerta Laçi

[blerta.laci@gea.edu.al](mailto:blerta.laci@gea.edu.al)

## 2.METODA: ‘PYETJET SOKRATIKE’

Në orën mësimore me temë “Divorci dhe e ardhmja e familjes” koncepti kryesor është divorci dhe gjithashtu diskutimi mbi të ardhmen e familjes si institucion. Qëllimi është që nxënësit jo vetëm të mësojnë, të kenë lirshmëri në dhënien e mendimit, të kenë një qasje kritike ndaj problematikave të familjes sot, por gjithashtu të ofrojnë zgjidhjet e tyre për të ndërtuar një familje të shëndetshme në kohët që jetojmë. Metoda që u përdor në këtë orë ishte: Pyetjet sokratike. Metoda u zbatua në këtë mënyrë:

- Nxënësit u vendosën në një tavolinë të rrumbullakët. Përpara kishin librat, blloqet e shënimeve dhe stilolapsat. Gjithashtu secilit nxënës iu shpërndanë disa karamelle dhe në qendër të tavolinës u vendos një kuti bosh.

- Pyetjet sokratike i ndihmojnë nxënësit të nxjerrin vetë konceptet e reja, të zbulojnë dhe kuptojnë me anë të dialogut/bisedës temën e mësimit dhe të nxjerrin vetë përkufizimet duke i drejtuar njëri – tjetrit pyetje për konceptet dhe çështjet e mësimit.
- Për këtë arsye nxënësit si fillim pyeten se ç’është divorci. Ata e shkruajnë për një moment në fletore dhe më pas secili ia prezanton grupit. Pas çdo mendimi të shprehur ata nxiten të pyesin njëri-tjetrin më thellë, për të zgjeruar shpjegimin e asaj që kanë shprehur. Ky shpjegim është pasojë e pyetjeve: Pse? Çfarë? Si? Kur?, etj. Çdo mendim i dhënë trajtohet si burim për një pyetje tjetër dhe çdo përgjigje është një nxitje për t’i dhënë një drejtim bisedës.
- Në momentin që ata mendojnë/ndiejnë/kuptojnë se kanë dhënë një mendim të saktë fusin një karamelle në kuti. Ky proces nxit rritjen e qasjes kritike, vetëreflektimit dhe sigurisë e vetëbesimit. Me anë të kësaj metode të gjithë patën mundësi të përfshihen dhe të mësojnë.
- Duke vijuar më tej bisedën, nxënësit ndihen të lirë për të lidhur teorinë me realitetin, duke sjellë shembuj nga jeta dhe qëndrimet e tyre ndaj këtij fenomeni social dhe të tjerëve.
- Pjesa kulmore është kur ata nxiten të japin zgjidhjet e tyre se si të përballet familja sot me sfidat e realitetit të përditshëm social, ekonomik, kulturor, teknologjik e politik.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën “Pyetjet sokratike” sepse krijon përfshirje të lartë në të nxënë duke nxitur zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik.

**Mësuesja: Orilda Kalami**

[orilda.kalami@gea.edu.al](mailto:orilda.kalami@gea.edu.al)

### **3.METODAT: ‘VËZHGO-ANALIZO-DISKUTO, RRJETI I DISKUTIMIT’**

Në orën mësimore të lëndës “Gjeografi”, klasa e 9 B, me temë mësimore “Shtimi natyror i popullsisë” dhe me koncepte kryesore: shtimi natyror, lindshmëri vdekshmëri, emigracion, zhvillime demografike, planifikim familjar, politika demografike, metodat e parashikuara si: “Vëzhgo-analizo-diskuot, Rrjeti i diskutimit” në planin e orës mësimore më mundësuan që nxënësit të përfshihen në të nxënë. Metodat u zbatua në këtë mënyrë:

- Klasa u organizua në grupe. Grupet do t’i referoheshin të dhënave të tabelës në tekst,dhe do të ndërtonin grafikun e ecurisë së shtimit natyror të popullsisë për vitet 1945-1990, 1991-2011, 2012-2023 sipas periudhave përkatëse. Nxënësve u kërkohet të analizojnë grafikun duke përcaktuar:
  - A ka grafiku të njëjtën ecuri përgjatë këtyre periudhave?
  - Nëse jo, cila është periudha me shtimin më të lartë dhe ajo me më të ultin?
  - Nisur nga të dhënat e tabelës, nxënësit përpiqen të gjejnë shkaqet e këtyre të dhënave.
  - Nxënësit përmbledhin faktorët që kanë përcaktuar ecurinë e shtimit natyror për këto periudha dhe plotësojnë faktorët që kanë ndikuar në shtimin natyror të popullsisë së vendit tonë pas viteve’90 .
- Më pas, duke i ftuar nxënësit në një diskutim të hapur,u kërkoi që të diskutojnë dhe analizojnë me argumente pyetjen: “Cilat parashikoni të jenë prirjet e shtimit natyror të popullsisë në vendin tonë në vitet e ardhshme?”
- Gjatë prezantimit të punës së secilit grup, por edhe gjatë diskutimit u vu re që nxënësit e kishin përvetësuar shumë mirë temën mësimore “Shtimi natyror i popullsisë”.

- Mua më pëlqen që të kërkoj analizime, argumentime dhe diskutime të hapura ku nxënësit mund të shprehin lirshëm mendimet e tyre.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që ta përdorin sa më shpesh metodën e vëzhgo-analizo -diskuto në grupe, si dhe teknikën rrjet diskutimi, sepse ajo krijon një ndërveprim mes nxënësve dhe të menduarin kritik duke u thelluar në analizën e diskutimit.

**Mësuesja: Jeta Melengu**

[jeta.melengu@gea.edu.al](mailto:jeta.melengu@gea.edu.al)

#### **4.METODAT: “PREZANTIM VIDEOJE” DHE “TURI I GALERISË”:**

Në orën mësimore të lëndës Gjuhë shqipe, klasa e 9-A, me temë mësimore “Manuali i djaloshit ambientalist” dhe me koncepte kryesore ‘ambient’, ‘ambientalist’ “‘ndotje’, ‘dekompozim’, ‘lëndë toksike’, metodat e parashikuara në planin e orës mësimore më mundësuan që të gjithë nxënësit të përfshiheshin në të nxënë. Metodatat u zbatuan në këtë mënyrë:

- Me qëllim që të ndërtoja njohuritë e reja duke përfshirë të gjithë nxënësit, vendosa të prezantoja para tyre një video që përmbante pamje nga natyra e bukur shqiptare, e shoqëruar në sfond me pak muzikë dhe në fund të videos disa pamje të trishta, ku dukej qartë ndotja e mjedisit me mënyra të ndryshme.
- Vura re që videoja u pa me shumë kureshtje nga nxënësit dhe të gjithë patën dëshirën për të komentuar rreth saj, si dhe për të dhënë mesazhe të bukura, plot domethënie për mbrojtjen e natyrës.
- Shumë interesante ishte edhe paraqitja e objekteve të ndryshme që nxënësit kishin përgatitur paraprakisht duke përdorur materiale të riciklueshme. Të gjithë nxënësit shfaqën dëshirën për të parë dhe dëgjuar me vëmendje për punën e shokut/shoqes.

Ua sugjeroj kolegëve të mi që t’i përdorin herë pas here ilustrimet me video apo turin e galerisë sepse i përfshijnë të gjithë nxënësit të marrin pjesë në procesin e të nxënësit në një mënyrë të këndshme/ argëtuese dhe nxjerrin në pah edhe aftësitë e tyre në fusha të tjera, si: Art, Shkencë apo TIK.

**Mësuesja Enkelejda Çaç**

[enkelejda.caca@gea.edu.al](mailto:enkelejda.caca@gea.edu.al)

#### **5.METODA “SHKRIM I LIRË”**

Në orën mësimore të lëndës gjuhë shqipe, klasa VI-A, me temë mësimore: Ushtrime për mënyrën dëftore të foljeve, dhe me koncept kryesor ‘Mënyra dëftore dhe koha e foljeve’, metoda ‘shkrim i lirë’, e parashikuar në planin e orës mësimore më mundësoi që pjesa më e madhe e nxënësve të përfshihen në procesin e të nxënësit.

Metoda “Shkrim i lirë” u zbatua në këtë mënyrë:

- U kërkova nxënësve që të shkruanin në fletore një tekst të shkurtër mbi filmin e fundit që kishin parë.
- Gjatë shkrimit, nxënësit do të përdornin folje në kohë të ndryshme të mënyrës dëftore.
- Pas përfundimit të kohës së përcaktuar për shkrimin:
  - Një nxënës lexoi tekstin e tij/saj përpara klasës.
  - Të tjerët identifikuan foljet gjatë leximit dhe i shënuan ato në fletore.
- Secili nxënës zgjodhi një nga foljet e identifikuara dhe përcaktoi kohën e saj.
- Rezultatet dhe vlerësimi:
 

Kam treguar kujdes që çdo nxënës të përzgjedhë një folje dhe të përcaktojë saktë kohën e saj. Aktiviteti nxiti angazhimin e plotë të të gjithë nxënësve dhe nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre aktive, u arrit rezultati i synuar për të nxënit. i përcaktuar për këtë koncept të orës mësimore.

U sugjeroj kolegëve të mi që të përdorin sa më shpesh metodën e “Shkrimit të lirë”, sepse ajo ndihmon në krijimin e një ndërveprimi dhe përfshirjeje të lartë në procesin e të nxënit, duke ndihmuar njëkohësisht në zhvillimin e aftësive krijuese dhe gjuhësore të nxënësve.

**Mësuesja: Albana Shabani**

**[albana.shabani@gea.edu.al](mailto:albana.shabani@gea.edu.al)**